



Moduli 4

Ndryshimet Klimatike People in Focus



Co-funded by
the European Union

Pivot

Moduli 4

Ndryshimet Klimatike

People in Focus



Co-funded by
the European Union

Table e Përmbajtjes

Kapitulli 1: Ndryshimet klimatike 5

1.1 Çfarë është ndryshimi klimatik?	5
1.2 Termat e përdorur për ndryshimet klimatike	6
1.3 Çfarë po e shkakton ndryshimin e klimës?	11
1.4 10 Mite mbi ndryshimet klimatike?	13
1.5 Si ndikon ndryshimi i klimës në botën natyrore dhe qeniet njerëzore	17
1.6 Migrimi nga klima dhe dhuna me bazë gjinore	22
1.7 Ndryshimet klimatike – kërcënim për të drejtat e njeriut?	25

Kapitulli 2: Si po angazhohet BE për të zbutur ndryshimet klimatike 28

2.1 Si filloi	28
2.2 Fit for 55	30
2.3 BE-ja neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050	31
2.4 COP dhe ndikimi i tij	33
2.5 Gjendja e Klimës në Europë	35

Aktivitetet 38

Aktiviteti 1: Çfarë ndodh nëse nuk ndodh?	38
Aktiviteti 2: Lojë me role – Këtu për ndryshimet klimatike	39
Aktiviteti 3: Një vizitë në Gaia	40

Referencat 42





Pyetësoni fillestar i vetëvlerësimit

Le të vlerësojmë njohuritë tuaja mbi ndryshimet klimatike

Përpara se të vazhdoni të eksploroni brenda kapitujve, ju ftojme të plotësoni formularin e vlerësimit në linkun e mëposhtëm për të zbuluar nivelin e njohurive tuaja mbi temat e trajtuara. Pasi t'i përgjigjeni të gjitha pyetjeve, do të merrni një email me rezultatet tuaja. Bëni më të mirën tuaj dhe krahasoni rezultatin tuaj me pikët e pyetësorit në fund të modulit.

https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSdduoMwDvxBrHdBbSkKPGlZr38G-5MZIXj6CEImpKzSF1EN_w/viewform?pli=1

Kapitulli 1

Ndryshimet Klimatike

1.1 Çfarë janë ndryshimet klimatike?



Ndryshimet klimatike i referohen ndryshimit në shkallë të gjerë dhe afatgjatë të motit dhe temperaturave mesatare në planetin tonë.

Shkenca është e qartë. Ndryshimi i klimës është fenomen i vërtetë. Ndryshimi i klimës po ndodh tani. Ndryshimi i klimës kërkon veprim të menjëhershëm dhe ambicioz për të parandaluar efektet negative që mund të ketë tek njerëzit dhe kafshët e egra në të gjithë botën.

Ne e dimë se planeti është ngrohur me një mesatare prej afro 1°C nga shekulli i kaluar. Nëse duam të parandalojmë efektet më të këqija/negative të ndryshimeve klimatike, ekziston një marrëveshje globale që rritja e temperaturës duhet të mbahet nën 2°C si në kohën para-industriale, me një ambicie për ta mbajtur atë nën 1.5°C. Aktualisht, megjithatë, vlerësimet sugjerojnë se tashmë jemi në rrugën e rritjes së temperaturës deri në 4°C ose më shumë.

Kohët e fundit kemi parë një numër zhvillimesh të padëshiruara për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ngrohjes globale:

- 16 nga 17 vitet më të ngrohta të regjistruara kanë ndodhur që nga viti 2001, ku 2016 ishte viti më i ngrohti deri më tani.
- Nivelet aktuale të gazeve serrë të përqëndruara në atmosferë nuk janë parë në 800,000 vitet e fundit.
- Dhe së fundmi, shkencëtarët kanë shpallur një periudhë të re kohore gjeologjike: Antropoceni, në të cilin aktiviteti njerëzor mendohet të ketë ndikim dominues në mjedisin, klimën dhe ekologjinë e tokës.

Ndërsa planeti vazhdon të ngrohet, modelet klimatike ndryshojnë. Moti ekstrem dhe i paparashikueshëm do të bëhet më i zakonshëm në të gjithë botën pasi modelet klimatike ndryshojnë, ku disa vende janë më të nxehta, disa vende më të lagështa dhe disa vende më të thata. Këto ndryshime mund të kenë (dhe kanë tashmë) ndikime drastike në të gjithë jetën në Tokë.

1.2 Termat e përdorur për ndryshimet klimatike

Ndryshimet klimatike janë një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme në jetët tona. Për t'u përfshirë në diskutime të ndryshme dhe për të qenë në gjendje për të ndërmarrë veprime konkrete, është e domosdoshme të njiheni me termat dhe konceptet e tij. Më poshtë mund të gjeni termat kryesore për ndryshimin e klimës.

Klima është mesatarja e modeleve të motit në një zonë specifike për një periudhë më të gjatë kohore, zakonisht 30 ose më shumë vjet që përfaqëson gjendjen e përgjithshme të sistemit klimatik.

Gazrat serë janë gazra që bllokojnë nxehtësinë nga dielli në atmosferën e planetit tonë, duke e mbajtur atë të ngrohtë. Që nga fillimi i epokës industriale, aktivitetet njerëzore kanë çuar në çlirimin e niveleve të rrezikshme të gazeve serrë, duke shkaktuar ngrohjen globale dhe ndryshimet klimatike.

Ngrohja globale është një rritje në temperaturën mesatare të sipërfaqes së Tokës që ndodh kur përqendrimi i gazeve serrë në atmosferë rritet. Këto gazra thithin më shumë rrezatim diellor dhe bllokojnë më shumë nxehtësi, duke bërë që planeti të nxehet më shumë. Djegia e lëndëve djegëse fosile, prerja e pyjeve dhe blegtoaria janë disa aktivitete njerëzore që çlirojnë gazra serë dhe kontribuojnë në ngrohjen globale.

Ndryshimet klimatike i referohen ndryshimeve afatgjata në klimën e Tokës që po ngrohin atmosferën, oqeanin dhe tokën. Ndryshimet klimatike po ndikojnë në ekuilibrin e ekosistemeve që mbështesin jetën dhe biodiversitetin, dhe madje edhe në shëndet. Gjithashtu, kjo shkakton ngjarje ekstreme të motit, si uragane më intensive dhe/ose të shpeshta, përmbytje, valë të nxehtit dhe thatësira, dhe çon në ngritjen e nivelit të detit dhe erozionin e bregdetit si rezultat i ngrohjes së oqeanit, shkrirjes së akullnajave, dhe humbjes së akullit.

Kriza klimatike i referohet problemeve serioze që shkaktohen ose mund të shkaktohen nga ndryshimet në klimën e planetit, duke përfshirë ekstremet dhe rreziqet e motit, acidifikimin e oqeanit dhe ngritjen e nivelit të detit, humbjen e biodiversitetit, mungesën e ushqimit dhe ujit, rreziqet shëndetësore, rënien ekonomike, shpërngulje dhe madje edhe konflikte të dhunshme.

Efekt i domino i klimës ndodh kur një ndryshim i klimës shkakton ndryshime të mëtejshme, në një reaksion zinxhir që përforcon veten me kalimin e kohës. Në fund të fundit, efekti domino mund të shkaktojë pika kthese dhe të shkojmë në një pikë ku ndryshimet në sistemet klimatike të planetit tonë bëhen të rënda dhe të pakthyeshme. Për shembull, ndërsa akulli i detit në Arktik shkrihet, më shumë nxehtësi po thithet nga ujërat më të errëta të oqeanit, duke përshpejtuar kështu procesin e ngrohjes dhe duke çuar në shkrirjen e akullit.

Një pikë kthese është një prag pas të cilit disa ndryshime të shkaktuara nga ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike bëhen të pakthyeshme, edhe nëse ndërhyrjet e ardhshme janë të suksesshme në uljen e temperaturave mesatare globale. Këto ndryshime mund të çojnë në ndikime të papritura dhe të rrezikshme me dëme shumë serioze për të ardhmen e njerëzimit dhe planetit tonë.

Gjurma e karbonit është një mjet matës i emetimeve të gazeve serrë të lëshuara në atmosferë nga një person, organizatë, produkt ose aktivitet i caktuar. Një gjurmë më e madhe e karbonit do të thotë më shumë emetime të dioksidit të karbonit dhe metanit, dhe për këtë arsye një ndikim më i madh në krizën klimatike.

Zbutja e ndryshimeve klimatike i referohet çdo veprimi të ndërmarrë nga qeveritë, bizneset ose njerëzit për të reduktuar ose parandaluar emetimet e gazeve serrë, ose për të përmirësuar mjediset me bimë që ndihmojnë në largimin e këtyre gazeve nga atmosfera.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike i referohet veprimeve që ndihmojnë në reduktimin e veprimeve cënues ndaj ndikimeve aktuale ose atyre që priten të vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike. Mund të përmendim ekstremet dhe rreziqet e motit, ngritja e nivelit të detit, humbja e biodiversitetit ose mungesa e ushqimit dhe ujit.

Rezistenca ndaj klimës është aftësia e një komuniteti ose mjedisi për të parashikuar dhe menaxhuar ndikimet klimatike, për të minimizuar dëmtimet e tyre dhe për të rikuperuar dhe transformuar sipas nevojës pas goditjes fillestare.

Drejtësia klimatike do të thotë vendosja e barazisë dhe e të drejtave të njeriut në qendër të vendimmarrjes dhe veprimit kur flasim për ndryshimet klimatike. Një aspekt i drejtësisë klimatike lidhet me përgjegjësinë historike të pabarabartë që mbajnë vendet e huaja në lidhje me krizën klimatike. Koncepti sugjeron që vendet, industrinë dhe bizneset që janë bërë të pasura nga aktivitetet që kanë emetuar më së shumti gazra serrë, kanë përgjegjësinë për të ndihmuar në zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike tek ata që preken, veçanërisht vendet dhe komunitetet më të cënueshme, të cilët shpesh janë ato që kanë kontribuar më pak në krizë.

Zgjidhjet e bazuara në natyrë janë veprime për të mbrojtur, ruajtur, restauruar dhe përdorur dhe menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme ekosistemet për të mbështetur përpjekjet për përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, për të ruajtur biodiversitetin dhe për të mundësuar jetesë të qëndrueshme.

Zero neto- Arritja e zeros neto kërkon që ne të sigurojmë që emetimet e dioksidit të karbonit nga aktiviteti njerëzor të balancohen nga përpjekjet njerëzore për të hequr emetimet e dioksidit të karbonit (për shembull, duke krijuar mjedise të posaçme të gjelbëruar për të thithur dioksidin e karbonit) - duke ndaluar kështu rritjen e mëtejshme të përqendrimit të gazeve serrë në atmosferë.

Mjedis i gjelbëruar me qëllim thithjen e karbonit është çdo proces, aktivitet ose mekanizëm që thith më shumë dioksid karboni nga atmosfera sesa çliron. Pyjet, oqeanet dhe toka janë rezervuarët më të mëdhenj natyrorë të karbonit në botë.

Ripyllëzimi është procesi i rimbjelljes së pemëve në zona që kanë pasur mbulesë pemësh së fundmi, por ku pyjet kanë humbur, për shkak të zjarreve, thatësirës, sëmundjeve ose aktivitetit njerëzor si pastrimi bujqësor.



Pyllëzimi është procesi i mbjelljes së pemëve në zona që nuk kanë qenë të pyllëzuara asnjëherë në histori. Pyllëzimi ndihmon në rikthimin e tokave bujqësore të braktisura dhe të degraduara, parandalimin e shkretëtirëzimit, krijimin e mjediseve të gjelbëruar për thithjen e karbonit dhe krijimin e mundësive të reja ekonomike për komunitetet lokale.

Ekonomia qarkulluese i referohet modeleve të prodhimit dhe konsumit që minimizojnë mbetjet dhe reduktojnë ndotjen, promovojnë përdorime të qëndrueshme të burimeve natyrore dhe ndihmojnë në rigjenerimin e natyrës.

Sigurimi i **një tranzicioni të drejtë** do të thotë që vendet zgjedhin të gjelbërojnë ekonominë e tyre përmes rrugëve dhe qasjeve të tranzicionit që përforcojnë barazinë dhe përfshirjen. Kjo do të thotë të shikojmë ndikimet e tranzicionit në grupe të ndryshme punëtorësh në të gjithë ekonominë dhe të ofrojmë mundësi për trajnim dhe rikualifikim që mbështesin punën e denjë dhe synojnë të mos lënë askënd pas.

1.3 Çfarë po e shkakton

ndryshimin e klimës?


Faktori kryesor i ndryshimit të klimës është efekti serë. Disa gazra në atmosferën e Tokës veprojnë paksa si xhami në një serë, duke bllokuar nxehtësinë e diellit dhe duke e ndaluar atë të kthehet përsëri në hapësirë dhe duke shkaktuar ngrohjen globale.

Shumë prej këtyre gazeve serrë ndodhin natyrshëm, por aktivitetet njerëzore po rrisin përqendrimet e disa prej tyre në atmosferë, në veçanti:


- dioksid karboni (CO₂)
- metani
- oksidi i azotit
- gazrat e fluorizuar

CO₂ i prodhuar nga aktivitetet njerëzore është faktori më i madh ndikues në ngrohjen globale. Deri në vitin 2020, përqendrimi i tij në atmosferë ishte rritur në 48% krahasuar me nivelin e tij para-industrial (para vitit 1750).

Gazet e tjera serrë emetohen nga aktivitetet njerëzore në sasi më të vogla. Metani është një gaz serrë më i fuqishëm se CO₂, por ka një jetëgjatësi më të shkurtër atmosferike.



Oksidi i azotit, si CO₂, është një gaz serrë jetëgjatë që grumbullohet në atmosferë gjatë dekadave deri në shekuj. Gazrat jo serë që e ndotin ambjentin, duke përfshirë aerosolet si bloza, kanë efekte të ndryshme ngrohëse dhe ftohëse dhe shoqërohen gjithashtu me probleme të tjera si cilësia e dobët e ajrit.



Shkaqet natyrore, të tilla si ndryshimet në rrezatimin diellor ose aktivitetin vullkanik vlerësohet të kenë kontribuar më pak se plus ose minus 0,1°C në ngrohjen totale midis 1890 dhe 2010.

Shkaqet e rritjes së emetimeve

- **Djegia e qymyrit, naftës dhe gazit** prodhon dioksid karboni dhe oksid azoti.
- **Prerja e pyjeve (shpyllëzimi).** Pemët ndihmojnë në rregullimin e klimës duke thithur CO₂ nga atmosfera. Kur ato priten, ai efekt i dobishëm humbet dhe karboni i ruajtur në pemë lëshohet në atmosferë, duke shtuar efektin serë.
- **Rritja e blegtorisë.** Lopët dhe delet prodhojnë sasi të mëdha metani kur tresin ushqimin e tyre.
- **Plehu** përmban azot dhe prodhon emetime të oksidit të azotit.
- **Gazrat e fluorizuar** emetohen nga pajisjet dhe produktet që përdorin këto gazra. Emetimet e tilla kanë një efekt shumë të fortë ngrohjeje, deri në 23 000 herë më të madh se CO₂.

1.4 Mitet mbi

ndryshimet klimatike



MIT 1

KLIMA E TOKËS KA NDRYSHUAR GJITHMONË

Gjatë historisë 4.5 miliardë vjeçare të Tokës, klima ka ndryshuar shumë. Kjo është e vertetë. Por ngrohja e shpejtë që po shohim tani nuk mund të shpjegohet me ciklet natyrore të ngrohjes dhe ftohjes. Lloji i ndryshimeve që normalisht do të ndodhnin gjatë qindra mijëra viteve po ndodhin në dekada.

Temperaturat globale tani janë në nivelin më të lartë që nga fillimi i regjistrimeve. Në fakt, 17 nga 18 vitet më të ngrohta të regjistruara kanë ndodhur që nga viti 2001.

MIT 2

BIMËVE I DUHET DIOKSIDI I KARBONIT

Bimët kanë nevojë për dioksid karboni (CO₂) për të jetuar. Bimët dhe pyjet heqin dhe ruajnë sasi të mëdha të dioksidit të karbonit nga atmosfera çdo vit. Por problemi është se ka vetëm aq shumë dioksid karboni dhe numri i bimëve në planetin tonë po zvogëlohet, pasi gjithnjë e më shumë pyje po priten në të gjithë botën, kryesisht për të prodhuar ushqimin tonë.

Le të jemi të qartë, CO₂ në vetvete nuk shkakton probleme. Është pjesë e ekosistemit natyror global. Problemi është sasia e CO₂ që prodhohet nga ne si njerëz; Nuk ka pasur këtë nivel të CO₂ në atmosferë për 800,000 vjet.

MIT 3

NGROHJA GLOBALE NUK ËSHTË REALE PASI ËSHTË ENDE FTOHTË

Ngrohja globale po bën që temperatura mesatare e sipërfaqes së Tokës të rritet. Kjo jo vetëm që mund të sjellë më shumë valë të nxehtit dhe thatësira, por gjithashtu po shkakton ndryshime në sistemet tona klimatike natyrore. Këto ndryshime po i bëjnë më të mundshme dhe më të rënda ngjarjet ekstreme të motit. Për shembull, uraganet dhe stuhitë po bëhen më intensive, duke lëvizur më ngadalë dhe duke u marrë më shumë kohë për të ndaluar.

MIT 4

NDRYSHIMET KLIMATIKE JANË NJË PROBLEM I SË ARDHMËS

Ky nuk është më një justifikim për të mos vepruar ndaj ndryshimeve klimatike dhe për të shtyrë barrën mbi brezat e ardhshëm. Vitin e kaluar, shkencëtarët më të mëdhenj të klimës në botë paralajmëruan se kemi vetëm 12 vjet për të kufizuar ngrohjen globale në një maksimum prej 1.5C dhe për të shmangur shaktërrimin e klimës

MIT 5

ENERGJIA E RIPËRTËRITSHME ËSHTË THJESHT NJË MËNYRË PËR TË FITUAR PARA

Është një besim i zakonshëm se energjia e ripërtëritshme është e shtrenjtë, por kjo thjesht nuk është e vërtetë! Energjia diellore dhe era në tokë janë mënyrat më të lira të prodhimit të energjisë elektrike; do të thotë se energjia që ata prodhojnë është më e lirë sesa përdorimi i lëndëve djegëse bërthamore, gazit dhe fosileve. Kostoja e burimeve të ripërtëritshme ka rënë më shpejt nga sa mund të parashikonte kushdo.

MIT 6

NUMRAT E ARINJVE POLARË PO RRITEN

Kjo nuk ndodh. Ndryshimet klimatike janë kërcënimi më i madh me të cilin po përballen arinjtë polarë. Arktiku po ngrohet afërsisht katër herë më shpejt se pjesa tjetër e botës, duke bërë që akulli i detit të shkrihet më herët dhe të formohet më vonë çdo vit. Kjo e bën më të vështirë për arinjtë polarë femra që të hyjnë në tokë në fund të vjeshtës për të ndërtuar strofkat e tyre dhe më të vështirë për ta që të dalin në akullin e detit në pranverë për të ushqyer këlyshët e tyre. Burimi kryesor i gjahut të tyre, fokat, ndikohen gjithashtu nga ndryshimet klimatike, pasi ato varen nga akulli i detit për të rritur të vegjlit e tyre.

MIT 7

ENERGJIA E RIPËRTËRITSHME MUND TË FUNKSIONOJË VETËM KUR NUK KA RE OSE ME ERË

Industria po zhvillon teknika të reja për ruajtjen e energjisë elektrike dhe menaxhimin e kërkesës në kohën e pikut që do të thotë se edhe nëse dielli nuk shkëlqen ose nuk po fryn një stuhi, është ende e mundur të mbështetemi në burimet e rinovueshme të energjisë.

MIT 8

KAFSHËT DO TË PËRSHTATEN ME NDRYSHIMET KLIMATIKE

Ky nuk është një mit, Darvini e ka kuptuar mirë pjesën e përshtatjes. Por le të jemi të qartë, disa bimë dhe kafshë do të përshtaten, por jo të gjitha. Për të mbijetuar, bimët, kafshët dhe zogjtë që përballen me ndryshimet klimatike kanë dy mundësi: të lëvizin ose të përshtaten. Ka disa shembuj të specieve që kanë filluar të përshtaten me ndryshimet klimatike tashmë. Duke pasur parasysh shpejtësinë e ndryshimit të klimës, është duke u bërë e pamundur për shumë specie që të përshtaten mjaft shpejt për të vazhduar në mjedisin e tyre të zakonshëm.

MIT 9

PO TË ELIMINOJMË NJËRËZIT, GJITHÇKA DO RREGULLOHET

Ne besojmë fuqimisht, që kjo është e gabuar. Është e lehtë të ndjejmë se ne kemi shkuar shumë larg tashmë dhe se planeti nuk do të jetë në gjendje të mbështesë popullsinë në rritje të botës.

MIT 10

KINA ËSHTË I VETMI VEND PËRGJEGJËS PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Pavarësisht se është një nga emetuesit më të mëdhenj të gazeve serrë, Kina është aktualisht një nga investitorët më të mëdhenj në burimet e ripërtëritshme. Rritja e investimeve ka qenë në përgjigje të rritjes së shpejtë të biznesit të gjelbër dhe nevojës për të pastruar ndotjen e ajrit në qytetet e saj kryesore. Ndryshimet klimatike janë një çështje globale dhe ne të gjithë kemi një përgjegjësi për t'iu përgjigjur krizës klimatike. Veprimi për të do të kërkojë investime serioze, por ka potencial për të sjellë përfitime të mëdha për natyrën dhe njerëzit



1.5 Si ndikon ndryshimi i klimës

bota natyrore dhe qeniet njerëzore

Ndryshimi i klimës është një kërcënim për natyrën tonë dhe ne si qenie njerëzore. Pasojat natyrore janë të shumta dhe katastrofike.

Temperaturat e larta

Kriza klimatike ka rritur temperaturën mesatare globale dhe po çon në ekstreme më të shpeshta të temperaturave të larta, siç janë valët e të nxehtit. Temperaturat më të larta mund të shkaktojnë rritje të vdekshmërisë, ulje të produktivitetit dhe dëmtim të infrastrukturës. Më së shumti do të preken anëtarët më vulnerabël të popullatës, si të moshuarit dhe foshnjat. Temperaturat më të larta pritet të shkaktojnë gjithashtu një zhvendosje në shpërndarjen gjeografike të zonave klimatike. Këto ndryshime po ndryshojnë shpërndarjen dhe bollëkun e shumë specieve bimore dhe shtazore, të cilat tashmë janë nën presionin e humbjes së habitatit dhe ndotjes.



Zjarri dhe thatësira

Për shkak të ndryshimit të klimës, shumë rajone tashmë po përballen me thatësira më të shpeshta, të rënda dhe më të gjata. Thatësira është një mungesë e pazakontë dhe e përkohshme e ujit, shkaktuar nga kombinimi i mungesës së reshjeve dhe rritjes së avullimit (për shkak të temperaturave të larta).

Thatësirat shpesh kanë efekte të dëmshme, për shembull në infrastrukturën e transportit, bujqësinë, pylltarinë, ujin dhe biodiversitetin. Ato ulin nivelet e ujit në lumenj dhe ujërat nëntokësore, pengojnë rritjen e pemëve dhe të mbjellave, shtojnë rrezikun për dyndjen e insekteve dëmtueshme dhe rrisin rrezikun e zjarreve.

Në Europë, shumica e humbjeve monetare vjetore , rreth 9 miliardë eurosh, shkaktohen nga thatësira, prekin bujqësinë, sektorin e energjisë dhe furnizimin publik me ujë. Thatësirat ekstreme po bëhen më të zakonshme në Europë dhe dëmet që ato shkaktojnë po rriten gjithashtu.

Disponueshmëria e ujit të freskët

Ndërsa klima nxehet, modelet e reshjeve ndryshojnë, avullimi rritet, akullnajat shkrihen dhe niveli i detit rritet. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në disponueshmërinë me ujë të freskët.

Thatësirat e shpeshta dhe të rënda, dhe rritja e temperaturave të ujit priten të shkaktojnë ulje të cilësisë së ujit. Kushtet e tilla nxisin rritjen e algave dhe baktereve toksike, të cilat do të përkeqësojnë problemin e mungesës së ujit që është shkaktuar kryesisht nga aktiviteti njerëzor.

Lumenjtë e Europës në përgjithësi burojnë nga zonat malore dhe 40% e ujit të freskët të Europës vjen nga Alpet. Megjithatë, ndryshimet në dinamikën e borës dhe të akullnajave, si dhe modelet e reshjeve mund të çojnë në mungesë të përkohshme të ujit në të gjithë Europën. Ndryshimet në rrjedhat e lumenjve për shkak të thatësirës mund të ndikojnë gjithashtu në transportin e brendshëm dhe prodhimin e energjisë hidroelektrike.



Përmbytjet

Ndryshimet klimatike pritet të sjellin shtim të reshjeve në shumë zona. Rritja e reshjeve për periudha të gjata do të çojë kryesisht në përmbytje fluiviale (lumore), ndërsa shpërthimet e shkurtra, intensive të reze mund të shkaktojnë përmbytje pluviale, ku reshjet ekstreme shkaktojnë përmbytje pa u tejmbushur asnjë masë uji.

Në disa rajone, disa rreziqe të tilla si përmbytjet e hershme në stinën e pranverës mund të sjellin ulje afatshkurtra të reshjeve dhe rreziku i shtuar i përmbytjeve të shpejta në zonat malore që mbingarkojnë sistemin lumor mund të kompensojë ato efekte në afat të mesëm.

Ngritja e nivelit të detit dhe zona bregdetare

Niveli i detit u rrit gjatë shekullit të 20-të dhe vazhdon të rritet me shpejtësi që nga dekadat e fundit. Rritja është kryesisht për shkak të zgjerimit termik të oqeanëve nga ngrohja. Por shkrirja e akullit nga akullnajat dhe shtresa e akullit të Antarktidës po kontribuon gjithashtu. Parashikohet që Europa do të përjetojë një rritje mesatare prej 60 deri në 80 cm të nivelit të detit deri në fund të shekullit, kryesisht në varësi të shpejtësisë me të cilën shkrihet shtresa e akullit të Antarktidës.

Krahas ndikimeve të tjera të ndryshimeve klimatike, rritja e nivelit të detit do të rrisë rrezikun e përmbytjeve dhe erozionit përreth brigjeve, me pasoja të rëndësishme për njerëzit, infrastrukturën, bizneset dhe natyrën në këto zona.

Biodiversiteti

Ndryshimet klimatike po ndodhin aq shpejt sa shumë specie bimësh dhe kafshësh po përpiqen t'i përballojnë. Ka prova të qarta që tregojnë se biodiversiteti tashmë po i përgjigjet ndryshimeve klimatike dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë. Ndikimet e drejtpërdrejta përfshijnë ndryshimet në fenologji (sjellja dhe ciklet e jetës së specieve shtazore dhe bimore), bollëkun dhe shpërndarjen e specieve, përbërjen e komunitetit, strukturën e habitatit dhe proceset e ekosistemit.

Tokat

Ndryshimet klimatike mund të përkeqësojnë erozionin, rënien e lëndës organike, kripëzimin, humbjen e biodiversitetit të tokës, rrëshqitjet e dheut, shkretëtirëzimin dhe përmbytjet. Efekti i ndryshimit të klimës në ruajtjen e karbonit në tokë mund të lidhet me ndryshimin e përqendrimeve të CO₂ në atmosferë, rritjen e temperaturave dhe ndryshimin e modeleve të reshjeve. Tokat e kripura pritet të rriten në zonat bregdetare si rezultat i depërtimit të ujërave të kripura nga bregu i detit për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe shkarkimeve (periodike) të ulëta të lumenjve.

Mjedisi Detar

Ndikimet e ndryshimeve klimatike, të tilla si rritja e temperaturave të sipërfaqes së detit, acidifikimi i oqeanit dhe ndryshimet në rrymat dhe modelet e erës do të ndryshojnë ndjeshëm përbërjen fizike dhe biologjike të oqeanëve. Ndryshimet në temperatura dhe qarkullimin e ujrave të oqeanit kanë potencialin të ndryshojnë shpërndarjen gjeografike të peshqve. Rritja e temperaturës së detit mund të mundësojë gjithashtu që speciet e huaja të zgjerohen në rajone ku më parë nuk mund të mbijetonin.

Tokat

Ndryshimet klimatike mund të përkeqësojnë erozionin, rënien e lëndës organike, kripëzimin, humbjen e biodiversitetit të tokës, rrëshqitjet e dheut, shkretëtirëzimin dhe përmbytjet. Efekti i ndryshimit të klimës në ruajtjen e karbonit në tokë mund të lidhet me ndryshimin e përqendrimeve të CO₂ në atmosferë, rritjen e temperaturave dhe ndryshimin e modeleve të reshjeve. Tokat e kripura pritet të rriten në zonat bregdetare si rezultat i depërtimit të ujërave të kripura nga bregu i detit për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe shkarkimeve (periodike) të ulëta të lumenjve.

Mjedisi Detar

Ndikimet e ndryshimeve klimatike, të tilla si rritja e temperaturave të sipërfaqes së detit, acidifikimi i oqeanit dhe ndryshimet në rrymat dhe modelet e erës do të ndryshojnë ndjeshëm përbërjen fizike dhe biologjike të oqeanëve. Ndryshimet në temperatura dhe qarkullimin e ujërave të oqeanit kanë potencialin të ndryshojnë shpërndarjen gjeografike të peshqve. Një temperaturë në rritje e detit mund të mundësojë gjithashtu që speciet e huaja të zgjerohen në rajone ku më parë nuk mund të mbijetonin.



1.6 Migrimi nga klima dhe

Dhuna me bazë gjinore

IOM-i e përkufizon migrimin klimatik si:

“lëvizja e një personi ose grupe personash të cilët, kryesisht për arsye të ndryshimeve të papritura ose të vazhdueshme në mjedis për shkak të ndryshimeve klimatike, janë të detyruar të largohen nga vendbanimi i tyre i zakonshëm, ose të zgjedhin ta bëjnë këtë, përkohësisht ose përgjithmonë, brenda një shteti ose përtej një kufiri ndërkombëtar.”


Migrimi nga klima është një nënkategori e migrimit nga mjedisi; ky lloj migrimi mund të lidhet me njerëz në situata të vështira, veçanërisht kur njerëzit detyrohen të lëvizin, ose mund të jetë një formë përshtatjeje për individët dhe komunitetet në mënyrë që ata të mësohen me këto ndryshime.

Fatkeqësitë natyrore shkaktuan 32.6 milionë zhvendosje të reja të brendshme në vitin 2022, duke e bërë atë shifrën më të lartë në një dekadë, si dhe 41 për qind më të lartë se mesatarja vjetore e dekadës së kaluar.^[1] (IDMC, 2023).

Kjo është një rritje prej 45 për qind në numrin total të personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV) për shkak të fatkeqësive natyrore në krahasim me vitin 2021. 98 për qind e 32.6 milionë zhvendosjeve të reja të fatkeqësive të brendshme në vitin 2022 ishin rezultat i rreziqeve të lidhura me motin, si stuhitë, përmbytjet dhe thatësitrat.

[1] <https://www.internal-displacement.org/global-report/grid2023>

Pesë vendet kryesore me numrin më të madh të zhvendosjeve të brendshme për shkak të fatkeqësive në vitin 2022 ishin Pakistani (8.2 milionë), Filipinet (5.5 milionë), Kina (3.6 milionë), India (2.5 milionë) dhe Nigeria (2.4 milionë).



Përveç kësaj, ndryshimi klimatik po ndryshon modelet e reshjeve dhe temperaturave dhe po rrit frekuencën dhe ashpërsinë e ngjarjeve ekstreme të motit në shumë pjesë të botës, të cilat të gjitha ndikojnë në sigurinë ushqimore duke reduktuar prodhimin bujqësor (IPCC, 2022), duke bërë që njerëzit të lëvizin sipas stinëve ose përgjithmonë nga zonat e rrezikuara. Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) projektton që më shumë se një miliard njerëz në mbarë botën mund të ekspozohen ndaj rreziqeve specifike të klimës bregdetare deri në vitin 2050, duke shtyrë potencialisht dhjetëra deri në qindra miliona njerëz të largohen nga shtëpitë e tyre në dekadat e ardhshme. Njerëzit më të varfër mund të kenë më shumë gjasa të migrojnë kur përballen me ndikime të ngadalta të ndryshimeve klimatike, të tilla si ulja numrit të mbjellave dhe të korrave, mungesa e ujit dhe rritja e nivelit të detit.

Ndërsa ndryshimet klimatike intensifikohen në mbarë botën, më shumë gra dhe vajza, veçanërisht ato në situata vulnerabël, po emigrojnë për të gjetur siguri, jetesë dhe mundësi punësimi.

Megjithatë, migrimi dhe zhvendosja si rezultat i ndryshimeve klimatike mund të përkeqësojnë gjithashtu rreziqet e dhunës, është konstatuar që rastet e dhunës me bazë gjinore shtohen pas fatkeqësive, veçanërisht për gratë dhe vajzat që janë të zhvendosura ose jetojnë në kampe ose vende të tjera. pa privatësi.

Dhuna në familje, dhuna nga partneri intim, abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, si dhe martesat e hershme dhe të detyruara të fëmijëve, gjithashtu rriten ndjeshëm gjatë krizave klimatike. Në Etiopi, për shembull, numri i vajzave të shitura në martesë të hershme në këmbim të bagëtive u rrit pas migrimit të shkaktuar nga thatësira, pasi familjet luftuan për të përballuar këto kushte ekstreme.

Në Malau, vajzat mund të detyrohen të martohen për shkak të mungesës së ushqimit të lidhur me ndryshimin e klimës. Rreth 1.5 milionë vajza në Malau janë në rrezik për martesë të detyruar si rezultat i mungesës së ushqimit dhe rritjes së varfërisë për shkak të ndryshimeve klimatike. Rritja e konflikteve globale, ndikimet e vazhdueshme pandemike, goditjet ekstreme të motit dhe klimës kanë krijuar stuhinë e "përsosur", duke çuar në nivele të paprecedentë të dhunës ndaj grave dhe vajzave, si dhe në trafikim dhe shfrytëzim seksual.

1.7 Ndryshimi i klimës

Nje kërcënim për të drejtat e njeriut ?

Ndryshimet klimatike kanë ndikuar ndjeshëm të drejtat e njeriut, veçanërisht në fushat si:

- **Siguria ushqimore, jeta, shëndeti dhe standardi i denjë i jetesës.** Sistemi industrial i ushqimit shkakton emetim të gazrave serrë, duke çuar në pasiguri ushqimore dhe uri. Ndryshimet klimatike ndikojnë negativisht në këto të drejta, duke prekur në mënyrë disproporcionale banorët ruralë, fermerët, pronarët e vegjël, peshkatarët, blegtorët, popujt indigjenë, familjet me të ardhura të ulëta, gratë, vajzat dhe fëmijët në zonën Jugore të globit.
- Ndryshimet klimatike ndikojnë gjithashtu **në të drejtën për ujë dhe kanalizime**, duke ndikuar në disponueshmërinë dhe cilësinë e ujit të pijshëm të pastër dhe objekteve sanitare. Ndryshimet klimatike ndikojnë gjithashtu në banesat dhe mjetet e jetesës, duke i detyruar banorët të zhvendosen ose të mbeten të pastrehë, dhe duke ndikuar në sistemet dhe jetët bujqësore.
- Ndryshimet klimatike ndikojnë gjithashtu në **arsim**, me ndërprerje në infrastrukturën arsimore që ndikojnë në cilësinë dhe aksesin në arsim.
- Grupet indigjene ndikohen drejtpërdrejt nga ndryshimet klimatike, pasi mënyra e tyre e jetesës mbështetet në ekosistemet që janë të ndjeshme ndaj efekteve të klimës. Kjo rrezikon të drejtën e tyre për vetëvendosje, pasi ata mund të detyrohen të braktisin tokat e tyre ndër breza për shkak të degradimit të mjedisit.

- Grupet vulnerabël, si popujt indigjenë, komunitetet lokale, fshatarët, emigrantët, fëmijët, gratë, njerëzit me aftësi të kufizuara, banorët e shteteve të vogla ishullore në zhvillim dhe ata në situata të vështira, janë në rrezik në mënyrë disproporcionale nga efektet negative të ndryshimeve klimatike. **Diskriminimi**, si racizmi, seksizmi dhe klasizmi, mund të kombinohen, të mbivendosen ose të kryqëzohen me këto përvoja, veçanërisht për ata që janë të pambrojtur.
- Ndryshimet klimatike kanë pasoja të rëndësishme mbi të drejtat e njeriut, veçanërisht për personat e moshuar, të cilët janë të prekur në mënyrë disproporcionale nga efektet e tij. Faktorë të tillë si vendodhja, varfëria, gjinia, moshë, origjina kombëtare ose sociale, statusi i lindjes dhe aftësia e kufizuar kontribuojnë në këto efekte. Dëmet që mund të sjellë klima, si sëmundjet e shkaktuara nga vektorët, stresi i nxehtësisë dhe fatkeqësitë natyrore mund të ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike dhe mendore. Megjithatë, të moshuarit kanë mençuri, përvojë dhe guxim të jashtëzakonshëm, duke e bërë udhëheqjen, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre , vendimtare për përpjekjet për të drejtat e njeriut.
- **Personat me aftësi të kufizuara** preken në mënyrë disproporcionale nga ndryshimet klimatike, pasi shumica janë të varfër. Veprimi klimatik i përgjegjshëm ndaj gjinisë është gjithashtu thelbësor, pasi diskriminimi i rrënjosur dhe sistematik mund të shkaktojë efekte të diferencuara gjinore.

- Ndryshimet klimatike ndikojnë gjithashtu në **të drejtat e fëmijëve**/ Ndikimet kryesore të ndryshimeve klimatike tek fëmijët përfshijnë motin ekstrem, fatkeqësitë natyrore, mungesën e ujit, pasigurinë ushqimore, ndotjen e ajrit, sëmundjet e transmetueshme dhe infektive, ndikimet në shëndetin mendor dhe ndikimet e ndryshme në situata të vështira.
- **Ndryshimet klimatike dhe e drejta për shëndet** janë të ndërlidhura dhe kërkojnë që shtetet të mbrojnë të drejtat e njeriut. E drejta për shëndet është një e drejtë universale, e pandashme e garantuar për të gjithë njerëzit dhe varet nga të drejta të tjera si kushtet e sigurta të punës, strehimi i përshtatshëm, ushqimi, uji, higjiena dhe arsimimi.

Për të lehtësuar efektet e të drejtave tona si njerëz, ne të gjithë duhet të ndër marrim veprime dhe të luajmë rolin tonë si qytetarë aktivë për të parandaluar përkeqësimin e situatës.



Kapitulli 2

Si po angazhohet BE për të zbutur ndryshimet klimatike



2.1 Si filloi

BE-ja është angazhuar në këtë çështje për të promovuar veprimet klimatike. Veprimet shumëpalëshe klimatike të BE-së janë si më poshtë:

Konventa e OKB-së për klimën

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, e miratuar vitin 1992, është traktati kryesor ndërkombëtar për luftën ndaj ndryshimeve klimatike. Objektivi i tij është të parandalojë ndërhyrjet e rrezikshme të shkaktuara nga njeriu në sistemin global të klimës. BE-ja dhe të gjitha vendet anëtare të saj janë ndër 197 Palët e Konventës.

Konferenca e Palëve (COP)

Konferenca e Palëve (COP) është një ngjarje vjetore gjatë së cilës vendet e botës mbledhen për të gjetur zgjidhje për krizën klimatike. COP është organi vendimmarrës i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Përveç Palëve në Konventë, përfaqësues të biznesit, organizatave ndërkombëtare, grupeve të interesit dhe shoqatave mund t'i bashkohen gjithashtu COP si vëzhgues. Nëpërmjet COP, BE-ja promovon veprime ambicioze për klimën. BE gjithashtu merr pjesë në Konferencën vjetore të Bonit për Ndryshimet Klimatike, e cila shtron bazën për diskutimet e COP.

Marrëveshja e Parisit

Në COP21 në 2015 në Paris, të gjitha Palët e UNFCCC miratuan Marrëveshjen e Parisit: marrëveshjen e parë universale, ligjërish të detyrueshme globale për klimën. Ata ranë dakord të kufizojnë rritjen e temperaturës globale nga revolucioni industrial deri në 2100 në 2°C, ndërsa vazhdojnë përpjekjet për të kufizuar rritjen edhe më tej në 1.5°C.

Protokolli i Kiotos

Para Marrëveshjes së Parisit, instrumenti i vetëm ligjërish të detyrueshëm në botë për uljen e emetimeve të gazeve serrë ishte Protokolli i Kiotos i vitit 1997.

Protokolli është ratifikuar nga 192 nga Palët e UNFCCC, duke përfshirë BE-në dhe vendet e saj anëtare. Megjithatë, për shkak se shumë emetues kryesorë nuk janë nënshkrues, Protokolli i Kiotos mbulon vetëm rreth 12% të emetimeve globale.

Organi më i lartë vendimmarrës i Protokollit të Kiotos është COP që shërben si Mbledhja e Palëve në Protokollin e Kiotos (CMP). Të gjitha palët në protokoll janë të përfaqësuara. Qeveritë që nuk janë palë marrin pjesë si vëzhgues.

Forume të tjera ndërkombëtare

BE-ja dhe vendet e saj anëtare marrin pjesë në forume ndërkombëtare, vendimet ose rekomandimet e të cilave ushqehen drejtpërdrejt ose tërthorazi në procesin e OKB-së. Këto përfshijnë:

- Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC)
- G7 dhe G20
- Forumi i Ekonomive të mëdha për Energjinë dhe Klimën (MEF)
- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)
- Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (IEA)

2.2 Fit for 55

Ligji europian i klimës e bën një detyrim ligjor arritjen e objektivit klimatik të BE-së për reduktimin e emetimeve të BE-së me të paktën 55% deri në vitin 2030. Vendet e BE-së po punojnë për legjislacion të ri për të arritur këtë qëllim dhe për ta bërë BE-në neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050.

Paketa Fit for 55 është një grup propozimesh për të rishikuar dhe përditësuar legjislacionin e BE-së dhe për të vendosur iniciativa të reja me synimin për të siguruar që politikat e BE-së të jenë në përputhje me qëllimet klimatike të miratuara nga Këshilli dhe Parlamenti Europian.

Paketa e propozimeve synon të sigurojë një kuadër koherent dhe të balancuar për arritjen e objektivave të BE-së për klimën, të cilat:

- sigurojnë një tranzicion të drejtë dhe shoqëror
- ruajnë dhe forcojnë inovacionin dhe konkurrencën e industrisë së BE-së duke siguruar një fushë loje të barabartë përballë operatorëve ekonomikë të vendeve të treta
- mbështesin pozicionin e BE-së si udhëheqës në luftën globale kundër ndryshimeve klimatike

2.3 Neutralitet i Klimës në BE në 2050

Të 27 Shtetet Anëtare të BE-së u angazhuan për ta kthyer BE-në në kontinentin e parë neutral ndaj klimës deri në vitin 2050. Për të arritur atje, ata u zotuan të reduktojnë emetimet me të paktën 55% deri në vitin 2030, krahasuar me nivelet e vitit 1990.

BE-ja tani ka objektiva ligjërisht të detyrueshëm klimatik që mbulojnë të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë.

Paketa e përgjithshme përfshin:

- objektivat e reduktimit të emetimeve në një gamë të gjerë sektorësh
- një objektiv për të rritur mjediset e gjelbëruara me qëllim thithjen e karbonit
- një sistem i përditësuar i tregtimit të emetimeve për të kufizuar emetimet, për të vendosur një çmim mbi ndotjen dhe për të gjeneruar investime në tranzicionin e gjelbër
- dhe mbështetje sociale për qytetarët dhe bizneset e vogla

Shtetet anëtare tani do të shpenzojnë 100% të të ardhurave të tyre nga tregtimi i emetimeve për projektet e lidhura me klimën dhe energjinë dhe dimensionin social të tranzicionit.

Fondi i ri i **Klimës Sociale** do të dedikojë 65 miliardë euro nga buxheti i BE-së dhe mbi 86 miliardë euro në total për të mbështetur qytetarët më të rrezikuar dhe bizneset e vogla në rrugën drejt tranzicionit të gjelbërt. Kjo do të sigurojë që të ketë mundësi për të gjithë, duke trajtuar pabarazinë dhe varfërinë energjetike, dhe duke forcuar konkurrencën e kompanive europiane, duke mos lënë askënd pas.

Për të siguruar një fushë loje të barabartë për kompanitë tona, **Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit** do të sigurojë që produktet e importuara do të paguajnë gjithashtu një çmim karboni në kufi në sektorët që mbulojnë. Ky është një mjet i vlefshëm për të promovuar reduktimin e emetimeve globale dhe për të shtyre tregun e BE-së të ndjekur synimet tona globale të klimës. Me standardet e reja të CO₂, **të gjitha makinat dhe furgonat e reja të regjistruara në Europë do të kenë emetim zero deri në vitin 2035**. Si një hap ndërmjetës drejt emetimeve zero, emetimet mesatare të makinave të reja do të ulen me 55% deri në vitin 2030 dhe furgonët e rinj deri në 50% deri në vitin 2030.

Si një hap i mëtejshëm në rrugën drejt neutralitetit klimatik, Komisioni paraqiti vlerësimin e tij për një objektiv klimatik të vitit 2040 për BE-në në shkurt 2024. Ai rekomandoi reduktimin e emetimeve neto të gazeve serrë në BE me 90% deri në vitin 2040 krahasuar me nivelet e vitit 1990, që është në përputhje me këshillat e fundit shkencore dhe angazhimet e BE-së sipas Marrëveshjes së Parisit. Parlamenti Europian dhe Shtetet Anëtare do të diskutojnë këtë objektiv dhe Komisioni i ardhshëm do të paraqesë propozime legjislative mbi këtë bazë.





United Nations
Climate Change



COP28UAE

DUBAI 2023



2.4 COP dhe ndikimet e tij

Si pjesë e përpjekjeve të tij drejt arritjes së neutralitetit global të klimës, Komisioni European merr pjesë në Konferencën e Palëve (COP) në kuadër të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Që nga viti 1995, Konferencat e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike bashkojnë palët për të përsheptuar veprimet drejt qëllimeve të Marrëveshjes së Parisit dhe Konventës në Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike.

Konferenca e 28-të e OKB-së për Ndryshimet Klimatike (COP28) u mbajt nga 30 nëntori deri më 12 dhjetor 2023 në Dubai. Nën presidencën e Emirateve të Bashkuara Arabe, samiti COP28 mblodhi palët së bashku për të përsheptuar veprimet drejt synimeve të Marrëveshjes së Parisit dhe Konventës Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike.

Angazhimet dhe veprimet kryesore të shpallura nga BE në COP28:



- për të përshpejtuar tranzicionin e largimit nga lëndët djegëse fosile këtë dekadë, për të ndërmarrë veprime për të reduktuar emetimet me 43% deri në vitin 2030 dhe për ta vendosur botën në një rrugë për të arritur emetimet neto zero deri në vitin 2050
- si pjesë e Betimit Global për burimet e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë, për të trefishuar kapacitetin e energjisë së rinovueshme dhe për të dyfishuar shkallën e përmirësimeve të efikasitetit të energjisë deri në vitin 2030. 2.3 miliardë euro nga buxheti i BE-së do të mbështesin tranzicionin e energjisë në fqinjësinë europiane dhe në mbarë globin
- 175 milionë euro mbështetje financiare nga BE-ja dhe Shtetet Anëtare të saj për të reduktuar emetimet e metanit
- mbi 400 milionë euro financim nga BE-ja dhe shtetet e saj anëtare për të aktivizuar një fond të ri të humbjeve dhe dëmeve për emergjencat klimatike
- dy projektet e para europiane të teknologjisë së pastër që do të mbështeten nga partneriteti BE-Catalyst për të ndihmuar BE-në të arrijë objektivat e saj klimatike për vitin 2030
- një kontribut prej 20 miliardë eurosh nga Ekipi i Europës në Iniciativën e Energjisë së Gjelbër Afrikë-BE
- një nismë e re Team Europe e fokusuar në zinxhirët e vlerave pa shpyllëzim

2.5 Gjendja e Klimës në Europë

Ky seksion ofron pamjen e vitit 2022 për Europën, krahasuar me tendencat afatgjata të ndryshueshme në të gjithë sistemin klimatik. Ngjarjet kryesore që ndodhën gjatë vitit përshkruhen gjithashtu brenda një konteksti klimatik. Eropa është ngrohur më shpejt se çdo kontinent tjetër në dekadat e fundit, me temperatura që rriten me dyfishin e normës mesatare globale.

- Temperatura e verës për Europën ishte më e larta ndonjëherë. 2022 ishte viti i dytë më i ngrohtë rekord për Europën, me 0.9°C më i ngrohtë se mesatarja. Për shumë vende në Europën Jugperëndimore, ishte viti më i ngrohti i regjistruar. Temperaturat më të larta mbi mesataren kanë prekur dhe Skandinavinë verilindore dhe ato vende që kufizohen me veriperëndimin e Detit Mesdhe.
- Liqenet dhe detet e Europës po shohin rritje të temperaturave të sipërfaqes. Temperatura mesatare e sipërfaqes së detit (SST) në të gjithë detet e Europës ishte më e ngrohta e regjistruar në vitin 2022. Në Detin Mesdhe, temperaturat ishin shumë më të ngrohta se mesatarja për një periudhë të zgjatur nga Maji e tutje, me valë të nxehta detare që thyen rekord gjatë verës. Temperaturat rekord të ngrohta të sipërfaqes së detit u vunë re gjithashtu në Gjirin e Biscay, Kanalin Anglez dhe Detin Irlandez dhe në Detin Norvegjez. Në të gjithë rajonin, 73% e liqeneve regjistruan temperatura më të ngrohta se mesatarja, me temperaturat më të ngrohta në Spanjë dhe më të ftohtat në Ukrainë.

- Temperaturat e larta dhe kushtet e thata kontribuan në përhapjen dhe intensifikimin e zjarreve, me sipërfaqjen e dytë më të madhe të djegur ndonjëherë
- Mungesa e reshjeve kontribuoi në kushtet dhe përhapjen e thatësirës . Viti në tërësi ishte 10% më i thatë se mesatarja. Maji ishte muaji më i thatë, me 21–28% më pak reshje se mesatarja, ndërsa shtatori ishte muaji më i lagësht, me 13–21% më shumë reshje. Kishte gjithashtu më pak ditë me lagështi se mesatarja, veçanërisht në Francë, Itali dhe Poloni.
- Për 10 muaj të vitit, shkarkimi i lumit ishte nën mesataren. Shkarkimi i lumit ishte i dyti më i ulëti në histori në të gjithë Europën, duke shënuar vitin e gjashtë radhazi me prurje nën mesatare. Për sa i përket zonës së prekur, ishte viti më i thatë i regjistruar, me 63% të lumenjve që kishin prurje nën mesataren. Në Mars, prurjet ishin më të ulëtat që nga fillimi i regjistrimeve, megjithëse Prilli pati prurjet e larta lumore më të përhapura, me 54% të rrjetit të lumenjve që kishte derdhje lumore mbi mesataren. Në Gusht, dy të tretat e rrjetit të lumenjve kishin shkarkime nën mesataren e lumenjve, ku një e treta kishte prurje jashtëzakonisht të ulëta, duke reflektuar kushtet e thatësirës. Rreth gjysma e rrjetit të lumenjve kishte prurje nën mesataren për pjesën e mbetur të vitit.
- Zona e dytë më e madhe e djegur në rekord në të gjithë vendet e BE-së. Këto kushte ekstreme të rrezikut nga zjarri lehtësuan ndezjen dhe përhapjen e zjarreve të mëdha në Europën Qendrore dhe në rajonin e Mesdheut, me zjarre kritike, ku mbuluan një sipërfaqe më të madhe se 10 000 ha, në Çeki, Francë, Portugali, Slloveni dhe Spanjë. Vlerësohet se në total janë djegur mbi 900 000 ha në të gjithë vendet e BE-së.

- Mungesa e borës në fillim të vitit kontribuoi në kushtet e thatësirës dhe përkeqësoi shkrirjen e akullnajave. Në pjesën më të madhe të Europës qendrore dhe jugore, dimri pati deri në 20 ditë më pak borë, ato me të paktën 1 cm thellësi bore, se mesatarja dhe deri në 50 c m në disa vende por këto ishin më të pakta. Në vitin 2022, akullnajat në Skandinavinë jugperëndimore përfituan nga numri pak më i lartë mesatar i ditëve të borës së dimrit, duke parë një rritje të lehtë në akull. Ndërkohë, akullnajat alpine panë humbje rekord të akullit, për shkak të mungesës së borës së dimrit dhe verës jashtëzakonisht të ngrohtë. Humbja e akullit të akullnajave ishte më shumë se 5 km³ në vitin 2022.
- Në vitin 2022, Europa përjetoj kohëzgjatjen më të lartë të rrezeve të diellit të parë ndonjëherë, me 130 orë më shumë diell se mesatarja, ku u pa me një prirje e theksuar drejt më shumë orëve me diell. Kjo anomali pozitive erdhi kryesisht nga orët me diell mbi mesataren midis Janarit dhe Korrikut. Nga Gushti e tutje, kohëzgjatja e diellit ishte më afër ose nën mesataren. Në përputhje me kohëzgjatjen më të gjatë të rrezeve të diellit, mbulimi vjetor i reve ishte i dyti më i ulëti në histori, me 4% më pak se mesatarja. Ishte më nën mesataren në pjesë të Europës perëndimore dhe juglindore, dhe pak mbi mesataren mbi Gadishullin Iberik dhe Europën e Largët Lindore.

Aktivitetet

Aktiviteti 1

Çfarë ndodh nëse nuk ndodh?



TITULLI I AKTIVITETI	Çfarë ndodh nëse nuk ndodh?
QËLLIMI I AKTIVITETIT /QËLLIMI	<ul style="list-style-type: none">• për të rritur ndërgjegjësimin për pasojat e ndryshimeve klimatike;• për të kuptuar pasojat e ndryshimeve klimatike në komunitetet lokale;• për të zhvilluar kreativitetin.
KOHËZGJATJA E AKTIVITETIT	90 min +
NUMRI I PJESËMARRËSVE	Ndani pjesëmarrësit në grupe me nga 4 persona
MATERIALE	Flipchart dhe shënues
PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	<ol style="list-style-type: none">1.Pjesëmarrësit të ndarë në grupe mendojnë mbi pasojat e mundshme të ndryshimit të klimës në komunitetin e tyre lokal (domethënë, çfarë ndodh nëse ata nuk ndërmarrin veprime ("nuk ndodh"?)).2.Grupet përgatisin një shfaqje të shkurtër për të ilustruar një ose më shumë nga pasojat e mundshme.3.Secili nga grupet prezantojnë shfaqjen para të tjerëve, të cilët përpiqen të zbulojnë se për çfarë saktësisht bëhet fjalë.
PËRMBLEDHJE DHE VLERËSIM	<p>Bëjuni pjesëmarrësve pyetjet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none">1.A ju kujton ndonjë nga skenat që sapo keni parë një situatë që keni përjetuar në komunitetin tuaj? Cila? Cili ishte rezultati?2.Cilët do të ishin faktorët apo pengesat që nuk ju lejojnë të ndërmerrni veprime?

Aktiviteti 2

Këtu për ndryshimet klimatike

TITULLI I AKTIVITETIT	Lojë me role – Këtu për ndryshimet klimatike
QËLLIMI I AKTIVITETIT /QËLLIMI	<ul style="list-style-type: none">• të tregojë se si mund të modifikohen situatat;• të përjetojnë aspekte të ndryshme të kontributit në veprimet klimatike• për të zhvilluar aftësitë e tyre të buta
KOHËZGJATJA E AKTIVITETIT	60 min +
NUMRI I PJESEMARRËSVE	Ndani pjesëmarrësit në 4 grupe
MATERIALE	Letër A4 me skenarin e shkruar për secilën nga 4 ekipet
PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	<p>Pjesëmarrësit ndahen në 4 grupe. Trajnerët i japin secilit grup një fletë me një skenar dhe ata duhet të përgatisin një shfaqje teatrale bazuar në të. Pas 15 minutash, grupet fillojnë të prezantojnë aktet e tyre të improvizuara. Çdo herë që grupi aktron skenarin e tij dhe më pas duhet ta luajë një herë të dytë dhe dikush nga audienca mund të thotë 'stop' dhe të hyjë në skenë, në mënyrë që të ndryshojë rrjedhën sipas këndvështrimit të tij/saj.</p> <p>Skenarët e dhënë janë:</p> <ol style="list-style-type: none">1.Komisioni European merr pjesë në COP29. Cilat angazhime merr përsipër?2.Parlamenti European diskuton objektivin neutral ndaj klimës për vitin 2040. Cilat objektiva duhet të arrihen?3.Shtetet anëtare të Bashkimit European po përballen me vështirësi për të arritur objektivat e Fit for 55. Si do ta trajtojë BE-ja problemin?4.Bashkimi European po përballlet me heqjen e të drejtave të njeriut për shkak të ndryshimeve klimatike. Si do të përballlet për të siguruar të drejtat themelore të njeriut për komunitetet e prekura? <p>Pas përfundimit të kësaj faze, pjesëmarrësit bëjnë një rreth dhe lehtësuesit bëjnë këto pyetje:</p> <ul style="list-style-type: none">• Si ishte për ju?• Çfarë vure re?• Si u ndjeve?• A do të ndryshoje diçka në mënyrën se si silleni?• Çfarë do të mbash mend pas kësaj?

Aktiviteti 3

Një vizitë në Gaia

TITULLI I AKTIVITETIT	Një vizitë në Gaia
QËLLIMI I AKTIVITETIT /QËLLIMI	<ul style="list-style-type: none">• të kërkojë mënyra për të krijuar një shoqëri gjithëpërfshirëse ku nuk ka nevojë për migrim dhe të drejtat e njeriut respektohen;• për të reflektuar se si këto masa mund të përdoren në kontekstin lokal;• për të praktikuar aftësitë e prezantimit
KOHËZGJATJA E AKTIVITETIT	90 min +
NUMRI I PJESËMARRËSVE	Ndani pjesëmarrësit në grupe me 5 persona
MATERIALE	Flipcharts, stilolapsa, letra me ngjyra, ngjitës etj.
PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	<ol style="list-style-type: none">1. Shpjegoni se secili prej grupeve është një delegacion që sapo ka vizituar komunitetin e Gaias, ku ata dëshmuar veprime të përsosura të ndryshimit të klimës që rezultuan në mungesë të migrimit të komuniteteve. Tani secili grup duhet të ndajë atë që pa me të tjerët.2. Jepuni grupeve 45 minuta për të përgatitur një prezantim vizual mbi masat, veprimet, rregulloret dhe idetë e tjera që janë zbatuar me sukses në Gaia.3. Ftoni delegacionet të bëjnë një raport të vizitës së tyre.4. Mblidhni në flipchart të gjitha idetë rreth masave që çojnë në zero efekte të ndryshimeve klimatike5. Hapni fjalën në seancë plenare për çdo koment, pikëpamje, etj.6. Kërkojuni pjesëmarrësve të mendojnë individualisht
	<p>Bëjuni pjesëmarrësve pyetjet e mëposhtme: Si u ndjetë kur imagjinonit vizitën tuaj në Gaia? Sa realiste janë masat e zbatuara atje? (Sa reale janë masat e propozuara dhe të paraqitura nga grupet e vogla?) A mund të bëhet një prezantim i tillë për kryebashkiakun apo autoritetet komunitare apo do të kishte nevojë për ndonjë përmirësim?</p>

Pyetësi përfundimtar i vetëvlerësimit

Le të vlerësojmë njohuritë tuaja rreth ndryshimeve klimatike

Ju lutem plotësoni këtë pyetësor të vetëvlerësimit pasi të keni fituar njohuri mbi çështjet e ndryshimeve klimatike. Mundohuni të krahasoni rezultatin me pyetësorin e parë në fillim të modulit:

<https://forms.gle/wz7DPcasnfwBGFKR7>

Referencat

Për Kapitullin 1:

- <https://www.wwf.org.uk/updates/here-are-10-myths-about-climate-change>
- <https://www.wwf.org.uk/what-we-do/climate-change-and-energy>
- <https://climatepromise.undp.org/news-and-stories/climate-dictionary-everyday-guide-climate-change>
- <https://www.unwomen.org/sites/default/files/2023-06/Policy-brief-Ensuring-safe-and-regular-migration-for-women-and-girls-in-the-context-of-climate-change-en.pdf>
- https://www.migrationdataportal.org/themes/environmental_migration_and_statistics
- https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=4558958#:~:text=Climate%20change%20is%20a%20pressing,%2C%20women%2C%20and%20indigenous%20peoples.
- https://climate.ec.europa.eu/climate-change/consequences-climate-change_en

Për Kapitullin 2:

- <https://www.consilium.europa.eu/en/5-facts-eu-climate-neutrality/#group-4-Inclusive-Europe-n6lQQOWHwA>
- https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/delivering-european-green-deal_en
- https://climate.copernicus.eu/sites/default/files/custom-uploads/ESOTC2022/PR/ESOTCsummary2022_final.pdf
- <https://www.consilium.europa.eu/en/policies/green-deal/fit-for-55-the-eu-plan-for-a-green-transition/>
- https://climate.ec.europa.eu/eu-action/international-action-climate-change/global-climate-action_en
- <https://www.un.org/en/climatechange/raising-ambition/climate-finance>

Për Metodologjinë e Edukimit Jo-Formal

- <https://rm.coe.int/0900001680aa6ce1>

Partnerët



Coordinator
FEMMES ENTRAIDE ET AUTONOMIE / France
www.feaasso.org



CESIE / Italy
cesie.org



People in Focus / Albania
peopleinfocus.org



SAVE A GIRL SAVE A GENERATION / Spain
www.saveagirlsaveageneration.org

Impressum


Ky botim është zhvilluar dhe publikuar në kuadër të projektit “Pivot. Të rinjtë promovojnë votën e informuar” (2023-1-FR02-KA220-YOU-000167160)

Koordinatori i Projektit: Femmes Entraide et Autonomie.

Partnerët e projektit: CESIE, People in Focus, Save a Girl Save a Generation

Dizajni: CESIE.

Botuar në qershor 2024. Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë megjithatë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian.



PiVot



KA220-YOU – Cooperation partnerships in youth

Financuar nga Bashkimi Europian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë të autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Europian dhe apo të "Agence du Service Civique- Agence Erasmus+ France Jeunesse & Sport". As Bashkimi Europian dhe as "Agence du Service Civique- Agence Erasmus+ France Jeunesse & Sport " nuk janë përgjegjës për ato.

Numri i projektit : 2023-1-FR02-KA220-YOU-000167160



**Co-funded by
the European Union**